



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministriy of lokal government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall :

KONKURS

Pozita : Një (1) Zyrtar për Logjistikë

Departamenti / Zyra:	Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
Grada :	Koeficienti 5
Raporton te :	Udhëheqësi i Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Zbatim efikas dhe efektiv i furnizimit , të Kabinetit të Ministrit , Departamenteve , Divizioneve dhe Sektorëve,
- Bënë bartjen e mallit në depo në bazë të kartelave për hyrje- dalje të mallit;
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e depos;
- Zbaton kërkesat dhe shpërndan mallin, sipas kërkesave të stafit të MAPL se ;
- Të mirëmbaj dokumentacionin furnizues
- Të dorëzojë pakot nëpër departamente dhe divizione të ndryshme;
- Të kryejë edhe detyra logjistike me qëllim të realizimit të punëve;
- Kryen pune tjera me kërkesë të udhëheqësit të divizionit,
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të divizionit dhe udhëheqësit të departamentit.

Kualifikimet dhe Përvoja:

Diplomë të shkollës së mesme, përparësi diploma universitare

Së paku 1 vite përvojë pune në lëmin përkatës

Trajnime në lëmin përkatës kanë përparësi

Aktet ligjore dhe aktet nën-ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit për pozitën Zyrtar për Logjistikë është në përputhje me LSHCK Nr.03/L -149 , në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare (1) , për pozita të karrierës .

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/Divizioni i Burimeve Njerëzore, Adresa Objekti Qeveritar (ish ndërtesa e "Rilindjes") Kati XII -zyra 1203 prej orës 08:00 – 16:00.

Gjithashtu aplikacionet mund të tërhiqen edhe në Web Faqen e MAPL -së " mapl.rks-gov.net ".

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Procedura e Konkurrimit Procedura e konkurrimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit .

Bazuar në nenin 11 paragrafi 3 të ligjit Nr.03 /L- 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ky post është i rezervuar për komunitetet jo shumicë.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: 038-200 35-511